

VENDIM
Nr. 92, datë 2.4.2026

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ELENERGJI” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 961/1 prot., datë 1.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Elenergji’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 284, datë 6.11.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Elenergji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në qarkun e Elbasanit.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë për plotësimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 340, datë 23.12.2025, vendosi të pezullojë procedurën e licencimit të shoqërisë “Elenergji” sh.p.k., duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve, pra brenda datës 24.3.2026, të depozitojë në ERE qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për korrigjimin e kapacitetit të instaluar dhe dokumentacionin tjetër të munguar të aplikimit. Ky vendim iu njoftua shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 2725/9 prot., datë 29.12.2025.

- Më pas, nëpërmjet *email*-it të datës 24.3.2026 dhe shkresës së protokolluar në ERE me nr. 964/1 prot., datë 26.3.2026, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion/informacion plotësues të aplikimit.

- Me depozitimin e dokumentacionit përkatës nga shoqëria brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit nr. 340/2025, rezulton se ka rënë kushti i pezullimit e si e tillë vlerësohet se duhet të vijohet me heqjen e tij.

Heqja e pezullimit dhe zgjatja e vendimmarrjes:

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores parashikohet se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.”.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrja e Bordit, në lidhje me aplikimin e shoqërisë për licencim, me qëllim zhvillimin e komunikimit, në lidhje me: informacionin/dokumentacionin përkatës nëse ka filluar ndërtimi i HEC-it brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së aktuale, përndryshe depozitimin e një VNM-je të re; depozitimin e dokumentacionit të mbështetjes financiare edhe për vlerën e mbetur të investimit; si dhe saktësimin në lidhje me datën e parashikuar për fillimin e operimit. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin, si më sipër, brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e Bordit nr. 340 datë 23.12.2025, “Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Elenergji’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.

2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Elenergji” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë në qarkun e Elbasanit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Elenergji” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti